VENDIM
Nr. 68, datë 22.11.2017

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR ZOTËRIMIN E PJESËMARRJES INFLUENCUESE (TË TËRTHORTË) TË SHOQËRISË "AMRYTA CAPITAL LLP", MBRETËRIA E BASHKUAR, NË KAPITALIN AKSIONAR TË "BANKËS CREDINS" SHA

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës "e", të nenit 43, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar, të shkronjës "gj", të pikës 1, të nenit 24, si dhe të nenit 25, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë", miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të ndryshuar, dhe të pikës 18, të shtojcës nr. 1, të rregullores "Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe finan-ciare", miratuar me vendimin nr. 36, datë 26.5.2010, të Këshillit Mbikëqyrës, të ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për zotërimin e pjesëmarrjes influencuese (të tërthortë) në masën 14.918 për qind të kapitalit aksionar të "Bankës Credins" sh.a. nga shoqëria "Amryta Capital LLP", Mbretëria e Bashkuar.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gent Sejko